



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 202

Më:26.04.2023

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, Ofertën me numër protokolli 676 i dt.06.04.2023 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në Gjimnazin "Hajdar Dushi" në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Kruja, Tirana dhe qyteti i Durrësit. Ekskursioni zgjatë 4 bujtje (gjithsejtë katër bujtje, pension i plotë) prej datës 04/05/2023 deri më 08/05/2023. Lista e konkurentëve për të fituar Ofertën për ekskursion të maturantëve të Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë, janë :

1. SH.P.K. "Armendi -Tours " me çmim 99.00 €
2. SH.P.K. "Meti –Tours me çmim 127.00 €;
3. SH.P.K. "Meti Commerc" me çmim 140,00€
4. N.P.SH."Dreni" me çmim 150.00€

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.13/04/2023 në ora 10:15 sipas ofertës nr.676 i dt.06/04/2023 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit dhe Gjimnazit "H.Dushi" Gjakovë :

1. z.Gani Binaku – Zëvendësdrejtori i Gjimnazit
2. znj.Shpresa Berisha - Përfaqësuesi i Këshillit Drejtues të Gjimnazit "Hajdar Dushi"
3. Flutur Këpuska – zyrtare e DKA
4. Zymer Berisha –Udhëheqës i Arsimit –DKA (asistim në hapje të ofertave)
5. Bujar Nuqi – Zyrtar ligjor DKA (procesmbajtës)

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese SHPK "Armendi -Tours"-Gjakovë ka konkuruar me çmim 99,00 € për Hotelin "Bonita Luxury" Kavajë me konfirmim rezervimi nga Kompleksi "Bonita". Në ofertë përfshihen katër (4) bujtje me pension të plotë që nga 04/05/2023 deri më 08/05/2023 dhe vizitat në qytetet e Republikës së Shqipërisë në Vlorë, Krujë, Tiranë dhe qytetin e Durrësit dhe gjithashtu ofron për secilin autobus nga një (1) nxënës me kushte të vështira ekonomike këtë përzgjedhje do të lë në kompetenc të Drejtorit të shkollës dhe vet stafit të shkollës. Firma ofron pishina të brendshme dhe të jashtme të gjitha në shërbim të nxënësve dhe stafit të shkollës.

Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.28/02/2022 gjer me dt.27/02/2027. Posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Baton Lleshi ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe firmës transportuese SHPK "Armendi -Tours" për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës

Gjimnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë. Janë të përfshirë 7 shoferë e të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 7 autobusë. Gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit (ARBK 4 faqe) të firmës dhe kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, ka ofruar 2(dy) Referenca me imazh pozitiv, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, po ashtu ka prezentuar Kontratë mbi shitëblerjen e automjetit LRP nr.3210/2023 ref.nr.874/2023 shitësi Talat Gashi N.T."ATMAXHA- TRANS" -Prizeren me SHPK "Armendi Tours" me përfaqësues Albin Gjoshi.

Ka prezentuar Konfirmim Rezervimi nga Kompleksi "Bonita" të vërtetuar nga pronari Astrit Ismaili së bashku me Licencën e Agjencionit të Akreditimeve të Ushqimeve -Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)-Republika e Shqipërisë (neni 11 paragrafi 2.21 i UA -02/2016) sipas ofertës nr.prot.676 dt.6.04.2023 pika (i) për akomodimin e nxënësve të shkollës Gjimnazi "Hajdar Dushi" Gjakovë mirëpo Komisioni kërkoj nga Kompania brenda një afati të shkurtër kohor (tre ditë) që të dërgohet dokumenti adekuat i Agjencionit të Akreditimeve të Ushqimeve nga Hoteli "Bonita Luxury" Kavaj ashtu si e ka deklaruar në Ofertën e vet agjensioni "Armend tours". Mirëpo takimi i radhës me përfaqësuesin e Kompanisë "Armendi tours" në DKA ku i është kërkuar edhe me shkrim në mënyrë elektronike datë 24.04.2023 Licenca e Agjencionit të Akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrim të nxënësve në Hotelin "Bonita -Luxory", por Kompania në fjalë ka deklaruar që nuk ka mundësi ta siguroj dokumentin e kërkuar që është edhe në Ofertën e Gjimnazit datë 6.04.2023 nr.676 pika (i).

Firma transportuese SHPK "Meti -Tours" -Gjakovë ka konkuruar me çmim prej 127.00€ për nxënës, ku në këtë çmim ka ofruar që kujdestarët e klasave lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës, të gjithë nxënësit janë të liruar nga të gjitha obligimet për shfrytëzimin e plazhit dhe shfrytëzimin e pishinës brenda hotelit.

Oferta bazohet në 4 (katër) bujtje me pansion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel "Bonita" Shpk Golem-Durrës prej dt.4/05/2023 deri më 08/05/2023 dhe vizitat në qytetet Vlorë, Krujë, Tiranë dhe qyteti i Durrësit gjithashtu ka prezentuar edhe Menun për këto 4 ditët e qëndrimit të nxënësve.

Janë të përfshirë nëntë (9) shoferë të pajisur me çertifikata mjekësore dhe janë prezantuar 8 autobusë, kanë marrëveshje bashkëpunimi me "Meti-Commerc" që e përfaqëson drejtori Zenel Musa në Skivjan.

Firma posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2019 gjerë më dt.06/06/2024. Ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të firmës mirëpo i mungojnë pjesët tjera të dokumentit kështu Komisioni ju dha afat që brenda një kohe të shkurtër (tre ditë) ta dërgojnë në zyret e DKA pjesët tjera të dokumentit, Kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, ka ofruar 3 referenca me imazh pozitiv, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, Licencën e Punës Dr. Baton Lleshi së bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania SHPK "Meti Tours" për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturantët).

Ka prezantuar Konfirmim rezervimi nga administratori Astrit Ismaili të Hotelit "Bonita" në Durrës me pronarin e SHPK "Metit Tours" Milazim Musa, Licencën e agjencionit të akreditimit të ushqimeve sipas ofertës me nr.prot.676 dt.6.04.2023 pika (i) të Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.



Firma transportuese SHPK “Meti –Comerc”-Gjakovë ka konkuruar me çmim prej 140.00€, për nxënës ku iu është ofruar qëndrim 6 ditor prej dt.02.05.2023 deri më 08.05.2023 ku nuk përkon me kërkesat e Ofertës së shkollës.

Posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.22/06/2021 gjer më dt.21/06/2026, nuk posedon Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të Gjimnazit “H.Dushi” në Gjakovë, ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të SHPK “Meti Comerc” . Për transportin e nxënësve ka përfshirë 5 shoferë dhe 6 autobusë ku sipas ofertës për ekskursion nuk i plotëson kushtet pasi numri i nxënësve është rreth 360 nxënës.

Firma transportuese N.P.SH. “Dreni”-Gjakovë (gjatë hapjes së ofertës mungoi pronari i firmës) ka konkuruar me çmim prej 150.00€, për nxënës ku iu është ofruar Ofertën me qëndrim 4 ditor në Hotelin “ELBA” .

Firma posedon Liçencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.09/11/2019 gjer më dt.08/11/2024, ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të SHPK “Meti Comerc” . Për transportin e nxënësve ka përfshirë 1 autobusë ku sipas ofertës për ekskursion nuk i plotëson kushtet pasi numri i nxënësve është rreth 360 nxënës. Dokumentacioni tjetër i kërkuar sipas Ofertës së Gjimnazit “H.Dushi i ka munguar.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurrese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, qëllimin e ekskursionit , lartësin e pagesës etj. ku me ç`rast takimi është mbajtur me prindër dhe kujdestarët e klasëve më dt.25.04.2023 ora 12:30 nr.prot.1076/1.

Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.13.04.2023 iu janë prezantuar Deklaratat e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (14 mësimdhënës).

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për shkollën Gjimnazi ”Hajdar Dushi” Gjakovë të përzgjedhet firma **SHPK “Meti Tours”** me çmim prej 127€.

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike **SHPK “Meti Tours”** nga Gjakova .

Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (14 arsimtarë), Deklaratat e Prindërve lidhur me organizimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e nxënësve pjesëmarrës në ekskursion, Procesverbali i mbledhjes me përfaqësues të Prindërve të kl.12-ta dhe Kujdestarë të klasëve të 12-ta të datë 25.04.2023 nr.prot.1076/1, Komisioni selektues dhe përfaqësuesit e prindërve jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) dhe kërkesat e dokumentacionit shtesë që ishin kërkuar t'i sjellin kompanit në zyret e DKA-së vendosi të përzgjedh për Gjimnazin "Hajdar Dushi" në Gjakovë firmën SHPK "Meti -Tours" me çmim prej 127 € .

Kompania e përzgjedhur në fjalë është e obliguar që nxënësit e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë që t'i respekton të gjitha zotimet në ofertë.

Komisioni selektues:

1. Gani Binaku
(emri dhe mbiemri)

Kryesues i Komisionit
(pozita)

dt. 26/04/2023

2. Shpresa Berisha
(emri dhe mbiemri)

Anëtar
(pozita)

dt. 26 /04/2023

3. Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)

Anëtare
(pozita)

dt. 26/04/2023



Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencive turistike
- Komisionit të Ankesave
- Shërbimit juridik
- Arkivit